

Bujqësia urbane (BU) është një industri e vendosur brenda ose në periferi të një qyteti, e cila prodhon, përpunon dhe shpërndan një larmi të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore, duke përdorur kryesisht burime njerëzore dhe materiale, produkte dhe shërbime në dhe përreth kësaj zone urbane. Fermat urbane tashmë furnizojnë me ushqim rreth 25% të popullsisë urbane të botës. Për shkak të rritjes së urbanizimit, BU është bërë më popullore në dekadat e fundit pasi shqetësimet për mjedisin, qëndrueshmërinë e prodhimit të ushqimit janë kombinuar me rritjen e interesit për këtë industri.

Parimi i BU për të shfrytëzuar parcela të vogla është veçanërisht i rëndësishëm për Kosovën ku madhësia mesatare e fermës është e vogël dhe zakonisht ndahet në një mesatare prej 8 parcelash. Këto mikroferma të organizuara si familje bujqësore karakterizohen me mundësi të vogla financiare, nivel të ulët të pajisjeve duke rezultuar kështu në rendimente të ulëta. Ky prodhim bujqësor ka potencial të lartë ekonomik dhe kërkon një sërë aftësish të reja që lidhen me kompetencat sociale (komunikimi ndër-kulturor, përfshirja sociale) dhe roli social i bujqësisë (ulja e varfërisë, rritja e cilësisë së jetës) që mund të arrihet përmes koncepteve të reja të biznesit dhe, njohurive teknike dhe punës intensive.

Projekti Erasmus Plus BUGI ka mbështetur zhvillimin e planprogramit të studimit master dhe programin LLL. Këto programe bazuar në strategjitë kombëtare, fermerët dhe analizat e nevojave të sektorit sipërmarrës, do të zhvillojnë strategji të reja për investime, mjete moderne të mësimdhënies dhe të nxisin transferimin e njohurive, aftësive dhe teknologjive në prodhimtarinë bujqësore dhe industrinë ushqimore.

Kurrikula e re, e bazuar në kompetenca, do të jetë ndërdisiplinore, duke nxitur procesin e ndërkombëtarizimit të procesit mësimor dhe të sigurojë fleksibilitet dhe lëvizshmëri të të mësuarit. Duke vepruar kështu, projekti do të rrisë kapacitetet, qëndrueshmërinë dhe atraktivitetin duke diversifikuar mundësitë e punësimit dhe përfshirjen sociale. Projekti do të kontribuojë në rritjen e punësimit të studentëve / pjesëmarrësve, zhvillimin e rrjeteve të reja dhe zinxhirët alternative të furnizimit me ushqim. Rezultatet e projektit do të rrisin qëndrueshmërinë urbane dhe zhvillimin e ekonomisë së gjelbër në Kosovë.



### Rezultatet e Projektit BUGI

- Udhëzuesi për bujqësi Urbane
- Raporti i planeve dhe strategjive të veprimit rajonal dhe të BE-së
- Modelet e fermave në rajon dhe analiza e zinxhirëve të furnizimit me ushqim
- Sondazhet e preferencave të konsumatorit
- Zhvillimi i strategjisë të fermave në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Malin e Zi
- Rezultatet e studimit të infrastrukturës së Universiteteve pjesëmarrëse në projekt
- Zhvillimi i Kurrikulave për programin studimor në master dhe LLL
- Udhëzues për hartimin e projekteve mësimore për mësimdhënësit
- Udhëzues për vlerësimin e aftësive dhe kompetencave
- Udhëzues për vendosjen e modulit
- Shtojcë diplome
- Vizita studimore në Itali, Gjermani dhe Slloveni për tu njohur me zbatimin e programeve të bujqësisë urbane
- Kuadri i performancës së cilësisë
- Strategjia e shpërndarjes
- Materiale mësimore
- Manuali në Moodle për BUGI
- Portali për ndërmarrje dhe aplikacioni android
- Akreditimi i programit studimor Bujqësia Urbane në nivel master
- Akreditimi i Programit Arsimit gjatë gjithë jetës (LLL)



## AKTIVITETI PROMOVUES (DERA E HAPUR) - PROJEKTI ERASMUS + " INICIATIVA E BUJQËSISË URBANE E BALLKANIT PERËNDIMOR - BUGI "

Serra është donacion i Projektit Erasmus Plus BUGI me qëllim të krijimit të kushteve ideale mjedisore për bimët. Ndërsa do të përdoret për të mbrojtur bimët nga kushtet e pafavorshme klimatike, serra siguron rendimente të larta duke ulur kostot e punës pasi përdorë sensorë për të monitoruar kushtet dhe automatizimin në serrë. Studentët dhe prodhuesit komercialë tani kanë mundësinë të shfrytëzojnë një gamë të gjerë teknologjish për të siguruar nivelet më të larta të produktivitetit me minimumin e punës.

